VENDIM
Nr. 59[1], datë 18.9.2006

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR VERIFIKIMIN E PASURIVE, LIDHJEVE NEPOTIKE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË ZYRTARËVE TË LARTË TË INSTITUCIONEVE KUSHTETUESE DHE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të neneve 3,5,6,8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike, si dhe personave të lidhur me ta, për periudhën 1992-2006.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar verifikon pasuritë, lidhjet nepotike dhe konfliktin e interesave të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, që gjatë periudhës së përcaktuar në pikën I, kanë ushtruar ose ushtrojnë detyrat e mëposhtme:

i) President i Republikës;
ii) Kryetar dhe zëvendëskryetar i Kuvendit;
iii) Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër dhe zëvendësministër;
iv) Kryetar dhe zëvendëskryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
v) Kryetar partie politike parlamentare;
vi) Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
vii) Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
viii) Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjyqtar i Gjykatës së Lartë;
ix) Drejtues institucioni të pavarur kushtetues dhe qendror publik.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryetar i Komisionit, në bazë të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", i takon grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

IV. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

1. Bujar Nishani	Kryetar
2.	zëvendëskryetar
3. Ramiz Çobaj	anëtar
4. Mehmet Hoxha	"
5. Genc Sharku	"
6. Astrit Patozi	"
7. Dashnor Sula	"
8.	"
9.	"

[1] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 4.5.2007 në pikën 4 shprehet;*
'' 4. Të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë objektin e hetimit në vendimin nr. 59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë.''

10. “

11. “

V. Afati i veprimtarisë së Komisionit është 5 muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Jozefina Topalli (Çoba)